



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, 4 Tetor 2011  
Nr. ref.: RK 139/11

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI 69/10**

Parashtrues

**Vehbi Halili**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr.  
5/2004, të 10 shkurtit 2004**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtrues është Vehbi Halili, me vendbanim në Vushtrri, Kosovë.



## **Vendimi gjyqësor i kontestuar**

2. Vendimi gjyqësor i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 5/2004, i 10 shkurtit 2004, që parashtruesit i ishte dorëzuar më 5 mars 2004.

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesi pohon që i është shkelur e drejta e tij e punës e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e drejtë kjo që garantohet edhe me konventat ndërkombëtare që zbatohen drejtpërdrejt përmes nenit 22 të Kushtetutës.
4. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese që ta zbatojë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë në rastin e tij në mënyrë që t'i mundësojë ta realizojë të drejtën e tij themelore të punës, me të gjitha të drejtat dhe detyrat e punës që i gëzonte para largimit.

## **Baza juridike**

5. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe rregulli 36 (3) (h) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

## **Procedura në Gjykatë**

6. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 30 korrik 2010.
7. Më 23 nëntor 2010, Kryetari, me Urdhrin Nr. GJR. 69/10, e caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar raportues. Po të njëjtën datë, Kryetari, me Urdhrin Nr. KSH. 69/10, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues.
8. Më 20 maj 2011, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve dhe pretendimeve të paraqitura nga parashtruesi**

9. Parashtruesi ishte i punësuar në Kuvendin Komunal të Vushtrrisë, në postin e nëpunësit të komisionit komunal gjatë vitit 1998.
10. Në vitin 1990 ai ishte larguar nga puna nga administrata e dhunshme në komunën e Vushtrrisë. Ai ishte larguar nga puna vetëm për shkak se ishte me prejardhje etnike shqiptare.
11. Pas largimit nga puna, parashtruesi i filloi procedurat në Gjykatën Komunale të Vushtrrisë në mars të vitit 2000. Me Aktgjykimin K No. 13/2000, të 16 tetorit 2000, Gjykata Komunale në Vushtri e miratoi kërkesën e parashtruesit dhe urdhëroi komunën e Vushtrrisë që ta kthente parashtruesin në punë si nëpunës të komisionit komunal, ose në ndonjë vend tjetër të punës që i përgjigjej kualifikimit të tij profesional.



12. E pakënaqur me këtë rezultat, komuna e Vushtrrisë ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës më 16 tetor 2000.
13. Më 13 nëntor 2003, Gjykata e Qarkut e Mitrovicës, me Aktgjykimin AC. Nr. 32/2001 tërësisht e ndryshoi aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Komunale të Vushtrrisë dhe e hodhi poshtë si të pabazë kërkesëpadinë e parashtruesit.
14. Më pas, parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.
15. Më 19 shkurt 2004, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin Rev. Nr. 5/2004, i cili, sipas parashtruesit, atij i ishte dorëzuar më 5 mars 2004.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

16. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
17. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) (h), i cili thotë:

*“Po ashtu një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur:*

*(h) kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën.”*

18. Për ta përcaktuar juridiksionin kohor të Gjykatës është me rëndësi të identifikohet, në secilin rast specifik, koha e saktë e shkeljes së supozuar. Me këtë rast, Gjykata duhet të marrë parasysh faktet për të cilat parashtruesi ankohet dhe përmasën e të drejtës së Kushtetutës që supozohet të jetë shkelur (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i Dhomës së Madhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Rastin Blečić kundër Kroacisë, Kërkesa Nr. 59532/0, e 8 marsit 2006, para. 82).
19. Gjykata vëren që parashtruesi ankohet se i është shkelur e drejta e punës, e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. Nr. 5/2004, të 10 shkurtit 2004, që i ishte dorëzuar më 5 mars 2004.
20. Kjo do të thotë që shkelja e supozuar e të drejtës së parashtruesit, e garantuar me Kushtetutë, ndodhi para 15 qershorit 2008, që është data e hyrjes në fuqi e Kushtetutës, dhe prej të cilës datë Gjykata ka juridiksion kohor.
21. Prandaj, rezulton që kërkesa e parashtruesit nuk është “*ratione temporis*” në pajtim me dispozitat e Kushtetutës.

### **PËR KËTO ARSYE**

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe rregullin 36 (3) (h) të Rregullores së punës, më 20 maj 2001, Gjykata Kushtetuese njëzëri



## VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

Altay Suroy



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. Dr. Enver Hasani